




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 2-D/DPK	Br. Prot. 01-693/15
Dep.	Prot No.
Nr. i faq.	Data
Broj stranica 02	Datum 10-03-2015
Nr. pages	Date



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 18 (paragrafi 4, 8 dhe 12) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 10.03.2015 mori:

V E N D I M

- I. Ekziston konflikt i mundshëm i interesit dhe mospajtueshmëri në ushtrimin e funksioneve në rastin me nr. AKK -03-4693/14, për z. Sabit Zeka - Zyrtar i Prokurimit në K.R.U.K. Bifurkacioni dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat.**
- II. Agjencia do të kërkoj nga institucioni ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.**
- III. Agjencia do të kërkoj fillimin e Procedurës për Kundërvajtje nga Gjykata kompetente.**
- IV. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.**

A r s y e t i m

I. Bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, neni 18 (paragrafi 1 dhe 3), si dhe në bazë të vendimit Nr. 03-4693/15 është hapur rasti nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi për zyrtarin e lartë, z. Sabit Zeka - Zyrtar i Prokurimit në K.R.U.K. Bifurkacioni dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.P.T "Saba".

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (AKK-DPK-01-4797/14), pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari i lartë është njoftuar për gjendjen në të cilin ndodhet dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtarit të lartë z. Zeka, i është bërë e ditur se gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë nuk mund të ushtroj funksion menagjues në biznes privat, kjo për faktin se Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Nr.04/L-051) e ndalon një gjë të tillë. Neni 15 (paragrafi 1) i këtij ligji shprehimisht thotë:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private”.

Përkundër afateve ligjore të dhëna nga Agjencia, duke përfshirë edhe shkresë paralajmëruese (AKK-01-251/15), zyrtari i lartë nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim të nevojshëm, për tu larguar nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin privat në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Prandaj, duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, vlerësojmë se zyrtari i lartë nuk e ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Bazuar në nenin 18 (paragrafi 8) të Ligjit (Nr.04/L-051), në rast se zyrtari i lartë vazhdon të kryej aktivitete apo funksione të papajtueshme sipas këtij ligji, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë, atëherë Agjencia i kërkon institucionit ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.

III. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e funksionit Publik (Nr.04/L-051) Neni 20, pika 1, çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuara në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3.

Sipas nenit 20 pika 2, “Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtari i lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit gjykata mund ti shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit”.

IV. Sipas Nenit 18 paragrafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

IV. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./ znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

